



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 28
Prishtinë, më 14 nëntor 2012, në orën 10:00, sala N-225
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Afrim Hoti, Albert Kinolli.

Mungoi: Armend Zemaj.

Të ftuar: z. Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Stafi mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri – koordinatorë; Mehmet Simnica - zyrtar i fushës për ekonomi.

Mbledhjen e kryesoi, Ali Sadriu - kryetar i Komisionit dhe Ramiz Lladrovci, zëvendës-kryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 07.11.2012;**
3. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011;**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 07.11.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 07.11.2012.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011

Kryetari – Vitin e kaluar ZAP-i ka dhënë 9 rekomandime, për MBPZHR-në, dhe lidhur me këtë, kjo e fundit ka përgatitur një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit. Mirëpo, edhe këtë vit ZAP ka vërejtur se zbatimi i planit të veprimit nga MBPZHR-ja është duke u zbatuar me hapa të ngadalësuar. Nga rekomandimet e dhëna, vetëm 3 janë adresuar plotësisht, 5 janë në proces të implementimit, ndërsa 1 nga rekomandimet nuk është adresuar fare. Te çështja e mosregjistrimit të pajisjeve të Institutit Bujqësor të Kosovës, si dhe mos regjistrimi i parcelave prej 4.8 hektarësh, bie edhe theksimi i çështjes sipas auditorit. Po ashtu, ZAP-i ka vërejtur se MBPZHR-ja, nuk ka evidencë reale mbi shfrytëzimin e automjeteve zyrtare, duke shtuar se veturat nuk kthehen në parkingun e Ministrisë, nuk ka evidencë mbi kilometrat e shfrytëzuara, mosplotësimi i fletudhëtimeve gjatë shfrytëzimit të veturave etj. , janë disa nga dobësitë lidhur me menaxhimin e veturave për MBPZHR-në.

MBPZHR-ja, ka bërë kontratë me punëtorët dhe pagesa për këta të punësuar ishte bërë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, po ashtu këtyre të punësuarve nuk u është ndaluar tatimi, i cili është në kundërshtim me Ligjin për pagesën e të ardhurave personale 03/L-115 neni 3. MBPZHR-ja, kishte rekrutuar këta të punësuar pa konkurse, me një arsyetim se kishte nevojë për shkak të fluksit të madh të punëve, për shqyrtimin e aplikacioneve për mbështetje të fermerëve. Mosrespektimi i planit dinamik nga operatorët ekonomikë (në sistemin e kanalit të ujitjes në Deçan), për këtë nuk është ndëshkuar operatori ekonomik. Më pastaj kemi rastin e eliminimit të operatorit ekonomik me çmim më të lirë, me arsyetim se ka planin me të gjatë dinamik të realizimit të projektit, pas analizës së auditorit del se operatori ekonomik, që ka fituar tenderin me çmim më të lartë, nuk ka arritur të implementojë projektin, sipas planit të paraparë. MBPZHR-ja, ka auditorin e brendshëm, Njësinë e Auditimit si dhe Komitetin e Auditimit. Njësia e Auditimit për vitin 2011, kishte përgatitur planin e auditimit me fushëveprim për auditimin e 9 fushave, të cilat ishin të audituara të gjitha. Kërkoj sqarim lidhur me këto të gjetura.

Ramiz Lladrovci – Përgëzoi Ministrinë për punën e mirë gjatë vitit 2011. Ishte i mendimit se në projektin në Strellcë, është dashur të zbatohen penaltitë. Inkurajoi Ministrinë që vitin e ardhshëm edhe theksimi i çështjes të mos figurojë në këtë Ministri.

Valbona Dibra - Tha se Raporti i auditimit është pasqyrë e saktë e punës së menaxhmentit të Ministrisë së Bujqësisë, e cila gjatë vitit 2011, ka shfrytëzuar buxhetin në mënyrë shumë racionale dhe në pajtim të plotë me Ligjin. Ky është shembull shumë i mirë i menaxhimit të parasë publike. Është për t'u vënë në fokus çështja e prokurimit, ku sipas auditorit, nga 67 mostra ka vetëm tri gjetje edhe ato gjetje janë më tepër të natyrës teknike. Prokurimi përbën sfidë për të gjitha institucionet, dhe deri më sot në KMFP, nuk është shqyrtuar asnjë raport me më pak të gjetura. Ky është sukses që i atribuohet menaxhmentit dhe ministrit të kësaj Ministrie. Nga 81 mostra, te subvencionet dhe transferet, sipas auditorit prapë të gjeturat janë shumë të vogla. Kjo është dëshmi se në këtë Ministri, menaxhimi i parasë publike bëhet në pajtim me ligjin dhe me një përgjegjësi të lartë. Një sukses me të cilin Ministria duhet të mburret, është edhe Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit, i cili ka realizuar planin e auditimit dhe ka kontribuar në veprimet e menaxhimit të Ministrisë gjatë periudhës 2011. Vlerësoi punën e stafit të Ministrisë dhe stafin e ZAP-it, për punë të mirë dhe raport shumë profesional.

Afrim Hoti – Pyeti lidhur me të gjeturën: “kontraktimi dhe servisimi i 5 traktorëve”, sipas të cilit kjo është bërë në kundërshtim me Ligjin. Pse ka ndodhur kjo?

Pastaj, raportimi i automjeteve dhe raportimi i kilometrazheve, të cilat nuk janë të qarta. Mos-

respektimi i kontratës nga ana e operatorit ekonomik për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve (servisimi i traktorëve). Kërkoj sqarim lidhur me këto të gjetura.

Bali Muharremaj – Nëse krahasojmë raportet e vitit 2010 dhe 2011 të kësaj Ministrie, vërehet se ka progres. Por, sfida për këtë Ministri mbetet zbatimi i rekomandimeve. Nga 9 rekomandime, 3 janë adresuar plotësisht, 5 janë në proces të implementimit, ndërsa 1 nga rekomandimet nuk është adresuar fare.

Pyeti: Cili rekomandim nuk është marrë fare në shqyrtim?

Për shkak të angazhimeve të kryetarit, kryesimin e mbledhjes e merr zëvendëskryetari i parë i Komisionit, deputeti Ramiz Lladrovci.

Blerand Stavileci, Ministër – Për Ministrinë është shumë me rëndësi që të shqyrtohen këto raporte. Ministria, në vitin 2007, ka pasur një buxhet prej 300 mijë euro, pastaj ka pasur rritje substanciale në vitin 2011 dhe në buxhetin e vitit të ardhshëm deri në 25 milionë euro. Këtu gjendet përgjigjja në pyetjen e parë, që ka të bëjë me angazhimin e personave të tjerë. Ministria ka një plan 7 vjeçar të punës, pra për vitin 2007-2013. Tani jemi duke përgatitur strategjinë afatgjatë për vitin 2014-2020, e cila bëhet në përputhje të plotë me dokumentin më të rëndësishëm për sektorin e bujqësisë, të Komisionit Evropian. Pra, janë politikat e përbashkëta bujqësore dhe këtu janë tri struktura më të rëndësishme: për bërjen e politikave, përgatitjen e masave, për ekzekutimin e masave që lidhen me subvencionet dhe grandet, si dhe për pjesën e monitorimit dhe të kontrollit. Është bërë riorganizimi i Ministrisë në përputhje me këto masa. Është përgatitur Rregullorja për sistematizimin dhe organizimin e brendshëm të Ministrisë.

Ministria ka shumë projekte të kontraktuara me donatorë, si me DANID-në dhe Bankën Botërore. Bashkë me mjetet e donatorëve, buxheti i planifikuar për vitin e ardhshëm është paraparë 35 milionë. Banka Botërore dhe të gjithë donatorët tjerë kanë qenë të vendosur për të përkrahur Ministrinë e Bujqësisë, pikërisht për shkak se ne jemi zotuar për themelimin e katër strukturave administrative, mirëpo në atë kohë ka qenë e pamundur të bëhet diçka për arsye të procedurave.

Sa i përket kontratave mbi vepër, nuk ekziston një gjë e tillë tani, por janë shërbime të veçanta, të cilat janë të rregulluara me Ligjin për shërbimin civil. Po ashtu, lidhur me këtë kemi edhe një interpretim nga Ministria e Administratës Publike, të datës 5 prill 2012, që ka të bëjë me përfshirjen e personave me kontratë të veçantë në sistemin e pagave.

Subvencionet në Ministrinë e Bujqësisë, janë tjera, krahasuar me ato të ministrive të tjera, sepse këto kanë të bëjnë drejtpërdrejt me prodhimin, kanë kriteret të përcaktuara si duhet bërë gjithçka, nga fillimi deri në fund. Janë procedura të rrepta, por që duhet t'u përmbahemi, sepse janë standard i BE-së.

Prokurimi, sipas mostrave të marra dhe përqindja e të gjeturave, del se gabimet janë vetëm teknike dhe atë në tri raste.

Përdormi i automjeteve- për të pasur një menaxhim transparent financiar, në mungesë të mjeteve kemi bërë të pamundurën që ato të shpërndahen dhe ta kemi një nivel të tillë të shpërndarjes së subvencioneve. Këto çështje logjistike, tashmë do të rregullohen me mbështetjen e donatorëve. Mjetet e personave të Ministrisë së Bujqësisë gjatë gjithë kohës kanë qenë në terren. Në mungesë të regjistrimit bujqësor dhe të regjistrimit kadastral të tokave bujqësore, nuk kemi një gjendje të saktë në terren. Duke ditur që regjistrimi bujqësor nuk do të bëhet edhe disa vite, automjetet që kanë qenë në dispozicion u janë vënë në dispozicion inspektorëve, në mënyrë që kontrolli të bëhet në terren. Si rezultat i këtij kontrolli, kemi kursyer miliona të buxhetit, sepse kanë qenë të deklaruar 14 mijë hektarë të rrejtshëm, po flasim për 1 milion e 400 mijë euro. Strukturat administrative të themeluara janë të një rëndësie shumë të madhe dhe si të tilla duhet të fuqizohet me staf të përgatitur, për të ekzekutuar në mënyrën më të mirë grandet dhe subvencionet.

Kapllan Halimi, sekretar, MBPZHR- Lidhur me kontratën mbi veprën, ekziston Ligji për shërbimin civil, është interpretimi i Ministrisë së Administratës Publike, mbi bazën e të cilit

janë bërë këto pagesa. Pra, nuk ka shkelje të ndonjë ligji në këtë çështje.

Sa i përket penaltive në dy projekte kapitale, njoftoi Komisionin se janë bërë penaltitë dhe është rishikuar strategjia për procesin e ujitjes. Regjistrimi i pasurisë, shikuar në vite- ka qenë problem i madh i MBPZHR-së, por që në vitin 2011, situata është prurë në një ose dy raste. Në Kosovë është problem me kadastrën dhe po flitet për një parcelë kadastrale që është në pronësi të Institutit Bujqësor të Kosovës, që është nënë përgjegjësinë e Ministrisë. Ajo nuk ka mundur të regjistrohet dhe lidhur me këtë jemi në proces.

Servisimi i traktorëve - Traktorët po të transportoheshin në Prishtinë, do të shpenzohej dyfishi i kontratës që ka pasur Ministria. Pra, jemi munduar që sa më pak të kemi shpenzime dhe gjithë kjo është bazuar në legjislacionin në fuqi. Marrëveshja është e bazuar në legjislacion dhe buxheti i Ministrisë është kursyer. Sipas analizës së kost-benefitit, është paraparë që riparimi të bëhet në vendin e ngjarjes.

Përdorimi i automjeteve është bërë në pajtim me UA për përdorimin e automjeteve. Ka 4 raste kur inspektorët nuk kanë raportuar me rregull dhe kjo është konstatuar si e gjetur nga ZAP-it. Ministria ka marrë masa në këto raste dhe është përmirësuar përdorimi i automjeteve zyrtare.

Mursel Hajlilji - Progresi në këtë Ministri është i dukshëm, megjithatë pyeti ZAP-in lidhur me të gjeturën për transfere dhe subvencione. Ky buxhet ishte 7 milionë e 805 mijë dhe është realizuar 99%. ZAP-i ka ofruar të dhëna për menaxhimin e 2 milionë e 888 mijë eurove dhe ka konstatuar disa gjetje. Si është menaxhuar ai 5 milionësh? A ka të dhëna ZAP-i për këtë pjesë të subvencioneve, apo Ministria me vetiniciativë e ka bërë këtë? A ka ndonjë të dhënë lidhur me këtë?

Artan Venhari, zëvendësauditor – Nga mostrat e marra lidhur me subvencionet, kontrolli i subvencioneve është parë se është dashur të jetë më i mirë, ndërsa menaxhimi i subvencioneve të bujqit ka qenë i menaxhuar shumë mirë. Në këtë Ministri, ka lëvizje pozitive shumë të mëdha edhe te regjistrimi i pasurisë. Qëllimi është që menaxhmenti i Ministrisë të ndihmohet të evitojë edhe lëshimet e vogla.

Ramiz Lladrovci – Sipas raportit të auditorit dhe përgjigjeve nga përfaqësuesit e Ministrisë, shihet se edhe rekomandimet e dhëna nga auditori tashmë janë adresuar, dhe bazuar në këtë, kjo Ministri duhet të merret shembull nga ministrinë e tjera për një punë të mirë dhe adresim të rekomandimeve.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011, nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zëvendëskryetari i parë i Komisionit,

Ramiz Lladrovci